



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për lirim të një anëtar dhe emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, propozim i Këshillit të Ministrave.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi dhe Ambra Barova.

Të ftuar:

Arbjan Mazniku – përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore

Majlinda Dhuka - përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të Statistikave Zyrtare

Oriana Arapi - përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të Statistikave Zyrtare

Albana Hashrova (Çami) – përfaqësuese e botës akademike

Eni Vasili – përfaqësuese e medias

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot, në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 17 dhe 23, të cilat i keni pasur zyrtarisht edhe në rrugë elektronike. Besoj se nuk ka pasur ndonjë propozim për ndryshim dhe nëse nuk keni ndonjë koment, po i quaj të miratuara procesverbalet e datave 17 dhe 23.

Faleminderit!

Gjithashtu, sot në rend dite kemi një seancë dëgjimore për lirimin e një anëtari dhe emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, propozim i Këshillit të Ministrave. Propozim për lirimin e zotit Adrian Kamenica nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave, propozim për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave si më poshtë vijon: zonja Majlinda Dhuka, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të Statistikave Zyrtare, zoti Arbjan Mazniku, përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore, zonja Oriana Apari, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të Statistikave Zyrtare, zonja Albana Hashorva (Çami), përfaqësuese e botës akademike, zonja Eni Vasili, përfaqësuese e medias. Në dijeninë time zonja Eni Vasili mungon, prandaj do të kemi një dëgjese të veçantë me zonjën Eni Vasili kur të paraqitet në komision.

Fillojmë me zonjën Majlinda Dhuka.

Zonja Majlinda, keni në dispozicion 5 minuta për prezantim, pasi ju jeni profesioniste e njohur dhe besoj se anëtarët e komisionit ju njohin mirë.

Fjala për ju.

Majlinda Dhuka – Zoti kryetar,

Të nderuar,

Ju falënderoj për mundësinë që më keni dhënë!

Unë quhem Majlinda Dhuka, jam me profesion juriste, e diplomuar në vitin 1999, pra rreth 20 vjet më parë. Aktualisht mbaj detyrën e drejtores së Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Këshillin e Ministrave. Kam kryer studimet pasuniversitare në studimet europiane dhe në të drejtën publike dhe jam në proces për titullin “Doktor” në të drejtën publike. Edhe më parë kam qenë anëtare e Këshillit të Statistikave si përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave ka vendosur përsëri të propozojë pranë Kuvendit të Shqipërisë kandidaturën time për anëtare të Këshillit të Statistikave.

Departamenti në të cilin punoj ka si detyrë kryesore koordinimin e proceseve të hartimit të politikave publike kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale. Në këtë kuptim kemi një interes të veçantë për statistikën zyrtare, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në vlerësimin e zbatimit të dokumenteve strategjike. Një rol tjetër që ka departamenti lidhet me koordinimin e proceseve për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ku Instituti i Statistikave ka një rol të rëndësishëm për vlerësimin e disa prej treguesve për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Një detyrë tjetër që kryen departamenti në të cilin unë punoj është ai i koordinimit të procesit për hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, si dhe raporti i vlerësimit të arritjes së objektivave të kësaj strategjie kombëtare për zhvillim dhe integrim, ku përsëri ka një pikëprerjeje të rëndësishme me të dhënat administrative dhe veçanërisht me statistikën zyrtare.

Nga vlerësimi im personal, si dhe nga eksperiencia ime si anëtarë në Këshillin e Statistikave në mandatin e kaluar, konstatoj se ka një zhvillim progresiv të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Ligji i ri i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2018 e ka forcuar më shumë pozitën e sistemit Kombëtar Statistikor, duke vënë në qendër përdoruesit kryesorë të statistikave gjë që reflektohet edhe me përbërjen e ndryshuar të Këshillit të Statistikave.

Në këtë kuptim edhe Këshilli i Ministrave konsiderohet si një nga përdoruesit kryesorë dhe unë kam detyrën të përfaqësoj një prej përdoruesve kryesorë, Këshillin e Ministrave në Këshillin e Statistikave. Përfaqësimi është i dykrahshëm, pasi nga një pikëpamje ne shprehim interes të veçantë për statistikën zyrtare si përdorues dhe për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, nga pikëpamja tjetër garantojmë edhe mbështetjen brenda sistemit të qeverisjes qendrore për Institutin e Statistikave, sidomos në ndërfaqen me institucionet publike si ministri apo agjenci të ndryshme publike në raport me marrjen e të dhënave administrative ose në raport me statistika zyrtare.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A keni pyetje? Nuk ka.

Zonjë, faleminderit! Në fund të mbledhjes së raportimit të prezantimit nga ana juaj, komisioni do të marrë vendim, por nuk ka asnjë dilemë se përfaqësuesit që kanë ardhur nga Këshilli i Ministrave jo vetëm që plotësojnë kriteret e integritetit profesional, por në vazhdimësi, si në shembullin tuaj, kanë treguar deligjencë profesionale në ndihmë të zhvillimit ekonomik.

Zoti Mazniku, ju do të jeni i fundit, po fillojmë me zonjën Albana.

Albana Hashrova - Përshëndetje!

Unë jam Albana Hashrova, pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë prej 32 vjetësh, me titullin “Profesor” dhe marr pjesë në këtë dëgjese si përfaqësuese e botës akademike. Puna ime si mësimdhënëse, si kërkuese shkencore, është lidhur ngushtë me statistikat, por edhe fakulteti ynë. Departamenti i Ekonomiksit ka pasur një lidhje të ngushtë me Institutin e Statistikave për të përdorur vazhdimisht statistikat në ndihmë të studentëve, të temave të diplomave dhe zhvillimit të mëtejshëm të tyre. Në një periudhë prej 8 vjetësh kam qenë drejtuese e Departamentit të Ekonomiksit dhe puna më ka lidhur me Institutin e Statistikave, e cila kishte të bënte me njohjen në detaje të këtij institucioni, sepse pothuajse i gjithë zhvillimi dhe zyrat kanë qenë në dispozicionin tonë në lidhje me punën që na është dashur dhe bashkëpunimin që kemi pasur në lidhje me to. Lidhja ime me Institutin e Statistikave mund të jetë e mëtejshme për të përçuar ato mangësi që ndoshta ka pasur ky bashkëpunim midis nesh dhe Institutit, ku do të them fjalën time dhe do të punoj për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Nuk besoj se është nevoja të zgjateni më tej në prezantim. Në vitet 2002-2004 kemi qenë kolegë në Fakultetin e Ekonomisë dhe unë mendoj se është nder për këshillin që t’ju ketë ju anëtare.

A ka pyetje për zonjën Albana?

Nuk ka.

Faleminderit!

Zonja Oriana ka fjalën.

Oriana Arapi- Përshëndetje!

Unë jam Oriana Arapi, punoj pranë Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, ku drejtoj Njësinë e Politikave të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, e cila ka disa funksione të rëndësishme, që kanë lidhje me statistikat zyrtare.

Ne kryejmë koordinimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në nivel kombëtar dhe jo vetëm, kryejmë edhe standardizimin e të gjitha dokumenteve të politikave që zhvillohen nga ministrinë e linjës.

Nga ana tjetër, kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë me INSTAT-in jo vetëm në lidhje me procesin e koordinimit të strategjive kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale, por edhe për procesin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Roli i departamentit dhe i njësisë që unë bëj pjesë lidhet me ndjekjen dhe koordinimin e procesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku një pjesë shumë e mirë janë edhe statistika zyrtare, të cilat raportohen nga INSTAT-i. Nga ana jonë, ne punojmë me

ministritë e linjës për të siguruar përcaktimin e targeteve për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe hartimin e raporteve periodikë.

Vitin e kaluar është hartuar edhe raporti kombëtar vullnetar për vitin 2018 për të gjithë vendin, që u prezantua në Nju Jork pranë OKB-së.

Pika e tretë është që ne punojmë edhe për të hartuar raportet e monitorimit për strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim, që ka një **set** të përcaktuar indikatorësh në bashkëpunim me INSTAT-in. Në këtë pikëpamje bashkëpunimi ynë me INSTAT-in është i natyrshëm jo vetëm në këmbime teknike, por edhe më gjerë për të parë edhe përfshirjen e të njëjtave këmbim të dhënash për formate të ndryshme, për pasaportat e indikatorëve, apo për procese që ne punojmë së bashku me INSTAT-in.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zonja Oriana!

Për mua nuk jeni e panjohur, përkundrazi, dhe në respekt të punës suaj, ju falënderoj!

Ka ndonjë pyetje për zonjën? Nuk ka.

Urime dhe suksese!

Zoti Arbian, fjala për ju.

Arbian Mazniku – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të prezantimeve edhe nga propozimet e tjera të Këshillit të Minsitrave, unë quhem Arbian Mazniku, kam studiuar “Gazetari” dhe më pas “Komunikim politik” në nivelin master.

Në periudhën 2007-2013 kam punuar në një institut kërkimor që quhet “Akhenda”, i cili është marrë në mënyrë tërësore me vlerësimin dhe analizën e të dhënave prej 6 vjetësh. Pas saj, për dy vjet kam shërbyer si zëvendësministër i Arsimit dhe që nga viti 2015 kam shërbyer si nënkryetar i Bashkisë së Tiranës.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ju jeni këtu për dy arsye: për shkak të funksionit, por edhe për shkak të kontributit që keni dhënë në vazhdimësi qoftë si zëvendësministër, apo si nënkryetar.

Respekt për punën tuaj!

Ka ndonjë pyetje për zotin Arbian? Nuk ka.

Faleminderit dhe suksese!

Do t’ju lutesha të na linit vetëm për vendimmarrjen dhe formatimin e vendimit.

Urime dhe suksese të gjithëve, përveç Eni Vasilit, që besoj se do të ketë një prezantim të veçantë, po kaq të stërzgatur sa juaji.

Bëni gati vendimin me gjithë Shërbimin e Monitorimit dhe pastaj të shtojmë një vendim të dytë, apo do t'i bëjmë të dy bashkë? Si thua, Elvi?

Ne kemi lënë pezull një dëgjese për KPP-në...

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti